



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:178653

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05867327

PKR.nr.269/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues, gjyqtari Gëzim Ademi, me anëtarët e trupit gjykues: Allten Murseli dhe Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.R., për shkak të veprës penale Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës më tutje shkurtesa (KPRK-së), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.29/2022 të datës 17.08.2023. Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 28.05.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit Bashkim Zeqaj, si dhe të pandehurit, me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare Faik Halili. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 29.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 27.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A.R., i ati S dhe e ëma S, e vajzërisë P, i lindur me datë ... në Gj, me vendbanim në rrugën “M. G”, K. në P., me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme profesionale – gastronomi, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa punë, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 11.03.2022 rreth orës 15:30, në rrugën “E. Q.” në Prishtinë, i pandehuri pa autorizim e me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes, ka poseduar substancë narkotike, ashtu që pasi është ndaluar nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës, është kontrolluar dhe në trup i është gjetur një sasi

e substancës narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 4.81 gram, si dhe një peshore e vogël digjitale me mbishkrimin “Constant”.

Me këtë ka kryer veprën penale Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par 1 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 69, dhe nenit 267 par 1 të KPRK-së e lidhur me nenet 364, 365 dhe nenit 449 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

1. Të pandehurit, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 1,000.00 (njëmijë) euro, të cilin dënim-gjobë i pandehuri obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
2. I njëjti dënimin e shqiptuar me gjobë mund të paguaj, me dy këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë. Në rast se i pandehuri nuk e paguan këtë gjobë, atëherë e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke ju llogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20 euro (njëzet euro) dënim me gjobë.
3. Gjykata, në mbështetje të nenit 276 par.1 dhe 2 të KPPRK-së dhe neneve 267 par.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ndaj të pandehurit lëshon këtë: URDHËR-URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si në vijim: substancës narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 4.81 gram, si dhe një peshore e vogël digjitale me mbishkrimin “Constant”..

URDHËROHET Policia e Kosovës që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin (asgjësimin) e sasisë së lartpërmendur të substancës narkotike dhe pajisjeve të tyre.
4. I pandehuri obligohet që t’i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej njëqind (100) euro, kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzën me numër PP.I.nr.29/2022 të datës 17.08.2023, ndaj të pandehurit A.R., për shkak të veprës penale Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par. 1 të (KPRK-së).

Gjykata lidhur me këtë çështje penale, me datën 15.09.2023, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku kanë prezantuar Prokurori i Shtetit, Ilaz Beqiri dhe i pandehuri, me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. L. K. G. Menjëherë pas leximit të aktakuzës, gjykata pyet të pandehurin se a e ka kuptuar dhe a ka nevojë për sqarime shitesë, duke i dhënë mundësinë që të deklarohe në lidhje me fajësinë, ku i pandehuri deklarohe se nuk ndjehet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, sipas aktakuzës. Gjykata në pajtim me nenin 240, par. 7 të KPPRK-së, e njoftoi të pandehurin dhe mbrojtësin që në afat prej 30 ditësh mund të paraqes kundërshtim të provave dhe kërkesë për hedhje të aktakuzës.

Mbrojtësja e të pandehurit, av. L. K. G. më datë 15.09.2023 ka paraqitur kundërshtimin e provave dhe kërkesë për hedhjen e aktakuzës. Me datë 05.10.2023, gjykata ka marr aktvendim me të cilin e ka refuzuar kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës si të pa bazuar, ndërsa mbrojtësja e të pandehurit ka paraqitur ankesë me datë 24.10.2023, e cila ankesë është refuzuar si e pa bazuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktvendimin PN.nr. 1438/2023 i datës 15.11.2023.

Në prani të këtyre rrethanave, Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datën 29.04.2024, ku ish-in të pranishëm Prokurori i Shtetit dhe i pandehuri me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare, ku edhe në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri ka deklaruar se ndihet i pafajshëm sa i takon veprës penale Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par. 1 të (KPRK-së) për të cilën është akuzuar. Meqë i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, gjykata ka proceduar me shqyrtimin gjyqësor, duke filluar me fjalën hyrëse të palëve, pastaj me administrimin e provave materiale dhe në fund me fjalën përfundimtare.

Fjala përfundimtare e palëve:

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 28.05.2024, Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: në këtë shqyrtim gjyqësor është vërtetuar në tërësi se i pandehuri A.R., me qëllim të shitjes së narkotikut dhe shpërndarjes, ka poseduar sasinë e narkotikut të përcaktuar si në dispozitivin e aktakuzës, deri sa i njëjti është arrestuar në flagrancë nga Policia e Kosovës.

Nga hetimi i mirëfilltë ka rezultuar si rezultat i aplikimit të masave të fshehta. Ashtu siç e deklarua edhe më parë, edhe nga i pandehuri se telefoni me numër 044 ... ka qenë i tij dhe po t'i shikojmë transkriptet nga aplikimi i masave të fshehta lidhur me të pandehurin A., shihet se i njëjti kishte rol aktiv në shitjen e narkotikut. Po ashtu, ky i pandehur gjatë ballafaqimit me këto transkripte, i njëjti është munduar t'i shmanget përgjigjeve, duke mohuar rolin e tij si shitës. Nga vetë përgjimet të cilat shihen në shkresa të lëndës, me shpërndarjen e narkotikut, i njëjti ka poseduar një sasi të vogël se e ka gjetur format se si ta shpërndajë. Andaj, kjo ka një lidhshmëri

edhe me vetë përgjigjen e tij, se të njëjtit nuk iu kanë gjetur as 100 gram e as 1 kg, çka d.m.th. se si formë e kryerjes së veprës penale e ka përdorur sasinë e vogël. Po ashtu, të njëjtit i është gjetur edhe një peshore, e cila shërben për matjen e narkotikut dhe kjo peshore, zakonisht gjendet tek shpërndarësit dhe kjo në pikëpamje të objektit të veprës penale e plotëson figurën e kësaj vepre penale, për faktin se sasia e narkotikut ka qenë dashur të matet në peshore dhe qëllimi i tij, edhe në bazë të dosjes kriminale të tij ka qenë shpërndarja. Tani më, është krijuar një metodologji nga ana e kryesve të veprave penale në përgjithësi dhe sot i të pandehurit në veçanti, duke u thirrur se e ka pasur në posedim. E gjithë kjo, bëhet për shkak të ikjes së përgjegjesisë penale dhe dënimit më të ulët për veprën tjetër. Andaj, gjykata mos t'ia fal fare besimin kësaj alibie, ngase kjo krijon një precedent të rrezikshëm për shoqërinë tonë dhe provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës, ekspertiza nga AKF, raportet, transkriptet mbi përgjimet, raportet policore mbi përgjimet, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve, natyrisht këto vërtetojnë dashjen direkte se i njëjti kishte për qëllim shitjen.

Po ashtu, gjatë aplikimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese, gjykatës i propozojmë për rrethana rënduese: se i pandehuri është marrë me një dukuri negative, me qëllim të dëmtimit të shoqërisë tonë nga narkotiku, i pandehuri ka një shkallë të lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale, gjë që u vërtetua edhe në këtë shqyrtim gjyqësor, i pandehuri fare nuk është penduar për këtë veprim, ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese, prokuroria edhe pse është munduar të gjejë ndonjë rrethanë lehtësuese në rastin konkret, kjo nuk ka qenë e mundur.

Andaj, si rezultat i gjithë kësaj, i propozojmë gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor, ta dënojë sipas ligjit dhe ta obligojë në shpenzimet e procedurës penale.

Mbrojtësi i të pandehurit A.R., Av. F.H. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e ka kundërshtuar në tërësi aktakuzën e Prokurorisë së Shtetit, nisur nga fakti se prokuroria ka dështuar në konstatimin e saktë të gjërave të shënuara në aktakuzë. Pra, nuk janë kryer hetimet siç duhet, për t'u vërtetuar me të vërtetë se në veprimet e të pandehurit manifestohen elementet e veprës penale. Nuk është kontestuese se i pandehuri është përdorues i narkotikëve që një kohë të gjatë, i njëjti është munduar t'i shmanget përdorimit të tyre, por në ditën kritike për të cilën pretendon prokuroria, është e vërtetë se i pandehuri i ka marr disa gjëra të hedhura nga persona të tjerë të panjohur për të dhe vetëm pasi që i ka marr në dorë, e ka vërejtur se është një sasi e vogël e narkotikut e pastaj, policia me rroba civile e ka ndaluar. Ne kemi analizuar edhe shumë biseda telefonike, që pretendohet se i pandehuri i ka zhvilluar me persona të tjerë, mirëpo nuk kemi hasur drejtpërdrejtë të përdoret fjala "narkotik", janë përdorur disa fjalë e në mesin e tyre ka disa fjalë ku thuhet: "A m'i ke pru ato patika?". Kështu që, duke u nisur nga fakti se nuk është vërtetuar se ka qenë fjala për narkotik, mendoj se këto janë vetëm supozime të prokurorisë dhe duke u nisur se prokuroria i posedon këto biseda telefonike, atëherë ka qenë dashur të identifikohet edhe ndonjë person tjetër saktë se me kë ka biseduar i pandehuri për t'u bërë lidhshmëria e të pandehurit me pretendimet e prokurorisë së cekura në aktakuzë.

I ka propozuar gjykatës që pas analizimit të të gjitha dëshmimeve, aktakuza e prokurorisë të hedhet dhe i njëjti të lirohet nga përgjegjësia penale. Por, në qoftë se gjykata do të bindet se në veprimet e tij manifestohen elementet e veprës penale për të cilën ngarkohet, të merr parasysh moshën relativisht të re, faktin se kur të rinjtë fillojnë të konsumojnë narkotikë, e kanë shumë të vështirë t'i shmangen konsumimit të tyre dhe mundësisht t'ia jepni një dënim sa më të butë.

I pandehuri A.R. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes në tërësi fjalën e mbrojtësit tim.

Provat e administruara:

Në këtë shqyrtim gjyqësor, gjykata konform nenit 7 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij, duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera. Gjithashtu, gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, ka administruar këto prova materiale:

- Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 11.03.2022,
- Raporti i ekspertimit me numër AKF/2023-1713/23-1582 të datës 07.07.2023,
- Foto dokumentacion që gjenden në shkresat e lëndës dhe
- Raporti i bisedave telefonike të realizuara në bazë të urdhëresës së gjykatës.

Nga prova materiale Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 11.03.2022, gjykata ka vërtetuar se nga i pandehuri ditën kritike janë sekuestruar sasia e narkotikut, si dhe është sekuestruar një peshore e vogël me mbishkrimin “C.” që shërben për matjen e narkotikut.

Nga prova materiale Raporti i ekspertimit me numër AKF/2023-1713/23-1582 të datës 07.07.2023, se për ekspertim është dërguar dëshmia #1: një qese letre me ngjyrë të bardhë, e mbyllur që përmban një paketim (foli alumini) në të cilin kishte substancë bimore me ngjyrë të gjelbër me peshë neto prej 4.81 gram, ky ekspertim ka vërtetuar se substanca bimore me ngjyrë të gjelbër është Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC).

Në bazë të shikimit nga fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës, vërehet në foto substanca narkotike dhe peshorja me mbishkrimin “C.”.

Nga prova materiale, raporti i bisedave telefonike të transkriptuara, të cilat biseda janë marrë në bazë të urdhëresës së gjykatës, gjykata ka vërtetuar se i pandehuri caktonte kontakte me persona të ndryshëm N.N, në lagjen “U.”, në mënyrë që t’iu shiste substanca narkotike të llojit marihuanë. Nga këto transkripte vërehet çartë roli i të pandehurit për të shitur substanca narkotike. Në një nga bisedat e transkriptuar, ku i pandehuri i drejtohet një personi, duke i thënë: “A me ta pru një?”, personi tjetër me emrin Z. i thotë: “Paj valla, bima njo, se qata dje ish kon kurgjo hiq”, i pandehuri i kthehet: “Jo, qita është shumë i mirë”, fjala është për narkotik. Z. i drejtohet: “Ok”, ndërsa i pandehuri i kthen: “Qe po ta bi”. Pastaj, në bisedën e datës 04.02.2022, i pandehuri me një person N.N. zhvillon bisedë për bari – marihuanë, që është shumë i mirë. Po ashtu, edhe në rrjedhën e bisedave të tjera, në këto përgjime vërehet roli i tij që është marr në mënyrë të vazhdueshme me shitblerjen e narkotikëve.

Mbrojtja e të pandehurit:

Në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë i pandehuri ka deklaruar se: më kujtohet se atë ditë isha në Internet te “Sh.”, kur kam dal nga aty, kishte pas shumë njerëz dhe kam parë tre persona në afërsi 5-6 metra, të cilët i kanë hedhë disa gjëra në tokë dhe janë larguar. Jam afruar dhe ato gjëra i kam marrë i futur në xhep, aty kishte pas substancë narkotike dhe ka qenë edhe vaga, në ato momente me kanë arrestuar 5 policë civil, më kanë gjetur në xhep barin, unë substancën narkotike e kam gjuajtur në një largësi prej 3 – 4 metra dhe në atë moment, njëri nga ta ka shkuar ta marr substancën narkotike, ndërsa peshoren e kam pasur në xhep dhe kur kam shkuar në stacion policor, aty e kam dorëzuar. E kam ditur se narkotikun e kanë gjuajtur në tokë ata tre persona dhe prandaj kam shkuar ta marr të njëjtën, ngase lokacioni ku është gjetur narkotiku është i njohur se përdoret narkotiku. E kam ditur se është e ndaluar të përdor narkotikun, mirëpo unë në atë kohë kam qenë përdorues i narkotikut nga viti 2018. Në atë kohë, e kam pasur vetëm një numër të telefonit 044 ... dhe atë ditë nuk kam komunikuar me askënd përmes telefonit. Unë pendohem shumë që i kam marr ato gjëra dhe jam munduar shumë të largohem nga substancat narkotike

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat një nga një dhe gjitha së bashku, në përputhje me nenin 360 të KPPRK-së, për veprën penale si në dispozitivin e aktakuzës ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Faktet jo kontestuese:

Nga të gjitha këto prova të administruara, për gjykatën nuk është kontestuese se te i pandehuri ditën kritike të ndalimit të tij nga zyrtaret policor i janë gjetur dhe sekuestruar, sasi e substancës narkotike, si dhe një peshore e cila shërben për matjen e substancës narkotike me mbishkrimin “C.”.

Nuk është kontestuese se i pandehuri substancën narkotike e kishte të paketuar në foli alumini, e cila substancë bimore ishte me ngjyrë të gjelbër dhe pesha e saj ishte 4.81 gram neto.

Nuk është kontestuese se i pandehuri ditën kritike ishte arrestuar në flagrancë nga Policia e Kosovës, në lagjen “U.” në P. në rrugën “E. Q.”, dhe nga i njëjti është sekuestruar substanca narkotike.

Nuk është kontestuese se numri i telefonit 044/... ishte në posedim dhe përdorim nga i pandehuri, të cilin fakt vetë i pandehuri ka deklaruar se në atë kohë ka pas vetëm një numër të telefonit, pra ishte ky numër telefoni për të cilin Gjykata kishte nxjerr urdhëresë për përgjimin e bisedave nga i pandehuri sipas kërkesës nga Prokuroria e Shtetit.

Faktet e lartcekura nuk kanë qenë kontestuese në këtë çështje penale. Përveç kësaj, faktet e tilla vërtetohen edhe nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe pjesërisht edhe nga deklarimi i të pandehurit.

Faktet kontestuese:

Kontestuese ka qenë fakti se i pandehuri substancën narkotike a e ka poseduar për shitje apo vetëm për posedim?

Gjykata nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, ka vërtetuar faktin se i pandehuri me datë 11.03.2022 rreth orës 15:30, në rrugën “E. Q.” në P., pa autorizim e me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes, ka poseduar substancë narkotike, ashtu që pasi është ndaluar nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës, është kontrolluar dhe në trup i është gjetur një sasi e substancës narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 4.81 gram, si dhe një peshore e vogël digjitale me mbishkrimin “C.”, të cilat i posedonte me qëllim të shitjes.

Gjykata nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor vërtetoi faktin se janë përmbushur në tërësi elementet e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së. Gjykata, duke vlerësuar me ndërgjegje të gjitha provat vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Fakti se i pandehuri e ka poseduar substancën narkotike me qëllim të shitjes është vërtetuar nga provat e administruar në shqyrtimin gjyqësor si nga prova materiale mbi vërtetimin për sekuestrimin e sendit të datës 11.03.2022, ku nga kjo provë vërtetohet fakti sa i pandehuri ditën kritike kishte poseduar substancë narkotike të llojit marihuanë të cilin e kishte për qëllim të shitjes si dhe një peshore digjitale me mbishkrimin “C.” e cila shërben për matjen e sasisë të substancës narkotike, një fakt të tillë të posedimit të substancës narkotike e pranon edhe vet i pandehuri në deklarimin e tij, me arsyetimin që është përdorues i substancës narkotike.

Substanca e dyshuar narkotike e sekuestruar nga i pandehuri, me rastin e arrestimit dhe ndalimit të tij me datë 11.03.2022, rreth orës 15:30 në rrugën “E. Q.”, dhe atë një qese letre me ngjyrë të bardhë, e mbyllur që përmban një paketim (foli alumini) në të cilin kishte substancë bimore me ngjyrë të gjelbër, me peshë neto prej 4.81 gram, është vërtetuar se substanca bimore me ngjyrë të gjelbër është Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), nga Raporti i ekspertimit të realizuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë më raportin e saj AKF/2023-1713/23-1582 të datës 07.07.2023.

Fakti se i pandehuri e ka poseduar substancën narkotike me qëllim të shitjes është vërtetuar edhe nga raporti i bisedave telefonike të përgjuara sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit dhe në bazë të Urdhërësës së Gjykatës të datës 20.01.2022 për zbatimin e masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, është urdhëruar që të bëhet regjistrimi i thirrjeve telefonike hyrje – dalje si dhe te teksteve të mesazheve elektronike për numrin e telefonit 044/... në emër të A.R., ku i pandehuri zhvillonte biseda dhe caktonte takime për persona të ndryshëm, me qëllim të shitjes së narkotikut, si nga biseda e transkriptuar e të pandehurit me personin Z. në lagjen “U.” i pandehuri i drejtohet duke i thënë: “A me ta pru një?”, pastaj personi Z. i drejtohet: “Paj valla, bima njo se qata dje ish kon kurgjo hiq”, i pandehuri i kthehet: “Jo, qita është shumë i mirë”, fjala është për narkotik. Z. i drejtohet: “Ok”, ndërsa i pandehuri i kthen: “Qe po ta bi”. Pastaj, në bisedën e datës 04.02.2022, i pandehuri me një person N.N. zhvillon bisedë për bari – marihuanë,

që është shumë i mirë. Po ashtu, edhe në rrjedhën e bisedave të tjera, në këto përgjime vërehet roli i tij që është marr në mënyrë të vazhdueshme me shitblerjen e narkotikëve.

Fakti se i pandehuri posedonte substancë narkotike vërtetohet edhe nga prova materiale të foto dokumentacionit që janë pjesë e shkresave të lëndës, ku ditën kritike pas ndalimit të pandehurit dhe sekuestrimit të substancës narkotike si dhe të peshores digjitale, të njëjtat janë fotografuar nga zyrtaret policor. Me vet prezencën e peshores e njëkohësisht edhe të substancës narkotike e po ashtu edhe kontakti dhe biseda me persona tjerë përmes transkriptove që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata vërtetoi faktin se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar si më lartë, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në bazë të provave të administruara u vërtetua në mënyrë të pakontestueshme se në veprimet e të pandehurit janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale, për të cilat është shpallur fajtor dhe atë për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së. Përkufizimi i kësaj vepre është “Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet”.

Gjykata ka vlerësuar deklarin e të pandehurit si pjesërisht reale dhe objektive ngase deklarimi i tij gjen mbështetje dhe përputhshmëri me provat materiale të administruar në shqyrtim gjyqësor, sepse i pandehuri e pranon se ditën kritike pas arrestimit nga zyrtaret policor, tek i njëjti janë gjetur sasi e substancës narkotike dhe një peshore digjitale e ky deklarim është në përputhje me provën materiale të vërtetimit për sekuestrimin e sendeve të datës 11.02.2022.

Sa i përket deklarin se i njëjti e ka pranuar se ishte konsumues i substancës narkotike dhe të njëjtën nuk e kishte për qëllim të shitjes, kjo deklaratë e tij se është konsumues, gjykata nuk e përjashton mundësinë që edhe mund të jetë konsumues i substancës narkotike, por nuk ja fali besimin deklarin të tij, ku thotë se substancën narkotike nuk e kishte për shitje, për faktin se bie në kundërshtim me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Po ashtu, gjykata vlerëson se vetë posedimi i peshores digjitale që është enkas për matjen e substancave narkotike ishte qëllimi i të pandehurit për shitjen e substancës narkotike. Për më tepër, ky qëllim i të pandehurit gjen mbështetje edhe në transkriptet e përgjimeve që gjenden në shkresat e lëndës.

Deklarimi i të pandehurit se është vetëm konsumues i substancës narkotike është bërë me të vetmin qëllim që të përfitoj nga fakti që të gjykohej për një vepër tjetër penale që parasheh dënim më të butë, po ashtu nga prova materiale e raportit të bisedave të përgjuara në bazë të urdhëresës së gjykatës për numrin e telefonit 044/..., e që i pandehuri e pranon se është numri i tij, gjykata ka vërtetuar se i pandehuri ka poseduar substancën narkotike me qëllim të shitjes së saj. Kjo vërtetohet me njërën nga bisedat e transkriptuara, ku i pandehuri i drejtohet një personi me emrin Z. duke i thënë: “A me ta pru një?”, pastaj personi Z. i drejtohet: “Paj valla, bima njo se qata dje ish kon kurgjo hiq”, i pandehuri i kthehen: “Jo, qita është shumë i mirë”, fjala është për narkotik. Z. i drejtohet: “Ok”, ndërsa i pandehuri i kthen: “Qe, po ta bi”. Pastaj, në bisedën e datës 04.02.2022, i pandehuri me një person N.N. zhvillon bisedë për bari – marihuanë, që është shumë i mirë. Pra, nga kjo bisedë vërtetohet qartë roli dhe qëllimi i të pandehurit në shpërndarjen dhe shitjen e substancave narkotike.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit, ne raport me këtë çështje penale, ku i njëjti thekson se e kundërshtuar në tërësi aktakuzën e prokurorisë së shtetit, nisur nga fakti se prokuroria ka dështuar në konstatimin e saktë të gjërave të shënuara në aktakuzë. Pra, nuk janë kryer hetimet siç duhet, për t'u vërtetuar me të vërtetë se në veprimet e të pandehurit manifestohen elementet e veprës penale. Ne kemi analizuar edhe shumë biseda telefonike, që pretendohet se i pandehuri i ka zhvilluar me persona të tjerë, mirëpo nuk është vërtetuar se ka qenë fjala për narkotik, mendoj se këto janë vetëm supozime të prokurorisë dhe duke u nisur se prokuroria i posedon këto biseda telefonike, atëherë ka qenë dashur të identifikohet edhe ndonjë person tjetër saktë se me kë ka biseduar i pandehuri për t'u bërë lidhshmëria e të pandehurit me pretendimet e prokurorisë së cekura në aktakuzë. Gjykata, pretendimet e mbrojtësit të pandehurit i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në provat materiale që gjenden në shkresat e lendes. Nga bisedat telefonike vërtetohet fakti se i pandehuri i ka shitur substanca narkotike personit të quajtur Z., duke i thënë: "Qita është shume te mire" nga se personi i quajtur me emrin "Z." ka shprehur dyshime në cilësinë e narkotikut të marr më parë dhe Z. ia kthen "Ok", pastaj i pandehuri ja dërgonte substancën narkotike. I pandehuri në ditën kritike kishte poseduar me veti edhe peshoren digjitale me qëllim të peshimit të narkotikut me rastin e shitjes, që varësisht nga pesha të pasoi edhe vlera monetare, ngase substanca narkotike ishte përgatitur në qese me qëllim të shitjes. Andaj, nga të gjitha këto prova të administruara në shqyrtim gjyqësor, gjykata ka arritur në përfundim se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës.

Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit:

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata morri parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e shqiptimit të dënimit konform nenit 69 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese gjeti moshën e re të pandehurit, ndërsa rrethana rënduese gjeti rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë, shkallën e përgjegjësisë penale, gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë veprë e kishte kryer me dashje dhe përgjegjshmërinë e plotë, faktin se këto vepra penale janë rritje e sipër, i njëjti është gjykuar dhe më parë për veprë penale të natyrës së njëjtë PKR.nr.223/2021, i plotfuqishëm me datë 25.03.2024 për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, PKR.nr.298/2021 i plotfuqishëm me datë 16.05.2022 dhe PKR.nr.72/2022, i plotfuqishëm me datë 30.05.2022, andaj të pandehurit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar me burgim dhe gjobë në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në pajtim, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale . Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Gjykata shqyrtoi mundësinë edhe për dënime tjera më të buta por në rastin konkret vlerëson se vetëm dënim me burgim dhe me gjobë është adekuat me personalitetin e kryerësit, marrë për bazë se i pandehuri ka të kaluar kriminale për vepra penale të natyrës së njëjtë dhe se dënime më të buta ndaj të njëjtit nuk do të arrinin qëllimin e dënimit.

Konfiskimi:

Gjykata, në mbështetje të nenit 276 par.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndaj të pandehurit ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të përshkruar si në dispozitiv. Në anën tjetër, sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike, nga këto arsye gjykata ka vendosur t'i konfiskoj përherë dhe të njëjtat ka urdhëruar që të shkatërrohen. Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm, dispozita e lartcekur e këtij Kodi, përcakton shprehimisht konfiskimin e detyrueshëm të tij.

Shpenzimet e procedurës:

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6, që kanë të bëjnë me shpenzimet për ekspertë dhe të paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore juridike:

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

Në bazë të arsyeve të dhëna si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.269/2023, Datë 27.06.2024

Bashkëpunëtori profesional
Albrim Kastrati

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari

Gëzim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejte ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykatë, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.